

**Treguesit e realizimit të  
buxhetit të Bashkisë Tiranë  
për 4-mujorin 2023**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>HYRJE</b>	<b>Fq.3</b>
<b>KAPITULLI I</b>	<b>Realizimi i Shpenzimeve të Bashkisë Tiranë për 4-mujorin 2023</b>	<b>Fq.4</b>
	Shpenzimet sipas programeve	Fq.5
	Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fq.6
	Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik	Fq.10
<b>KAPITULLI III</b>	<b>Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve</b>	<b>Fq.14</b>
<b>KAPITULLI III</b>	<b>Ecuria e buxhetit të Bashkisë Tiranë për 4-mujorin e viteve 2019-2023</b>	<b>Fq.44</b>

**RAPORT MONITORIMI**  
**I**  
**BASHKISË TIRANË PËR 4-MUJORIN 2023**

---

**HYRJE**

---

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr.7, datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësitë të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”; Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; VKB nr. 126, datë 23.12.2022 “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023, (i ndryshuar), paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin 2023, duke analizuar performancën financiare në funksion të arritjes së objektivave dhe realizimit të shpenzimeve sipas programeve.

Raporti bazohet në të dhënat për shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare, duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit.

Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është e rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje, dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Tashmë, që nga viti 2015 zbatohet Reforma Administrative dhe Territoriale (RAT) dhe e decentralizimit të funksioneve të reja.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me VKB nr.23, datë 17.03.2023, të ardhurat e papërdorura të vitit buxhetor 2022 trashëgohen në buxhetin e vitit 2023.

Informacioni i përcjellë në këtë raportim është realizuar jo vetëm nga raportet e tërhequra nga SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) por dhe nga informacioni i përcjellë në mënyrë shkresore nga Drejtoritë e Bashkisë Tiranë dhe Institucionet e Varësisë të përfshira në këtë proces.

Bashkia Tiranë po vijon me likuidimet e angazhimeve të marra dhe ka vijuar evidentimin dhe përfshirjen në buxhet të detyrimeve të prapambetura nga viti 2022 sipas informacioneve të sjella edhe nga strukturat të cilat menaxhojnë funksionet e Bashkisë.

Nga ana tjetër, dinamika me të cilën ecin punët në Bashkinë Tiranë kërkon jo vetëm rishikime të projekteve në vazhdim, por edhe kërkesa për të shtuar projekte dhe shpenzime të reja për të maksimizuar nevojat e institucionit në funksion të qytetit.

# KAPITULLI I

---

## REALIZIMI

### I

#### SHPENZIMEVE TË BASHKISË TIRANË PËR 4-MUJORIN 2023

Bashkia Tiranë, gjatë kësaj periudhe, ka menaxhuar dhe realizuar shpenzime sipas 25 programeve buxhetore, Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës, bazuar në funksionet bazë dhe të deleguara sipas ligjit për qeverisjen vendore, konkretisht:

1. Programi Planifikim, Menaxhim & Administrim
2. Programi Gjëndja Civile
3. Programi Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore
4. Programi Shërbimet e Policisë Vendore
5. Programi Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile
6. Programi Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik
7. Programi Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve
8. Programi Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit
9. Programi Administrimi i Pyjeve & Kullotave
10. Programi Rrjeti Rrugor Rural
11. Programi Transporti Publik
12. Programi Menaxhimi i Mbetjeve
13. Programi Planifikim Urban Vendor
14. Programi Strehimi
15. Programi Programet e Zhvillimit
16. Programi Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
17. Programi Shërbimet Publike Vendore
18. Programi Sport dhe Argëtim
19. Programi Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
20. Programi Arti dhe Kultura
21. Programi Arsimit Bazë përfshirë arsimin parashkollor
22. Programi Arsimit i Mesëm i Përgjithshëm
23. Programi Përkujdesja Sociale
24. Programi Strehim Social
25. Programi Emergjenca Civile
26. Fondi Rezervë
27. Fondi i Kontigjencës

Buxheti fillestar i Bashkisë Tiranë për vitin 2023 është 28,772,876,650 lekë. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transferten e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale, TVSH Detyrime dhe Donatorët.

Referuar akt-rakordimeve përfundimtare, fondi i mbartur në total është në vlerën 6,757,520,420 lekë, i përbërë: nga të ardhurat e mbartura dhe të papërdorura në shumën 5,581,298,094 lekë; nga transfertat

e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme në shumën 1,130,438,851 lekë dhe nga donatorët në shumën 45,783,475 lekë.


Referuar Akt-rakordimit përfundimtar të fondit të rindërtimit, vlera e mbartur është 1,846,033,212 lekë.

## 1. Çështje të rishpërndarjes së buxhetit gjatë periudhës

- Përfshirja e kërkesave dhe e detyrimeve të krijuara rishtazi në buxhetin e vitit 2022, për Aparatin e Bashkisë si dhe për të gjitha institucionet e varësisë së Bashkisë së Tiranës, si dhe sistemime në zërat e investimeve duke sjellë si rezultat shtesa, pakësime apo rishpërndarje fondesh si rezultat i dinamikës pas hapjes nga periudha e pandemisë.
- Fondet e trashëguara të rindërtimit nga viti 2022 përdoren për të njëjtin qëllim për të cilin janë akorduar bazuar në VKM-të, si rindërtimi i objekteve arsimore në zonat e prekura nga tërmeti , rindërtimi/rikonstruksioni i objekteve arsimore, përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesat (pallat) dhe ndërtesa publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji”, dhe njësitë administrative 6, zonat e “Kombinatit” Bashkia Tiranë, rindërtimi i banesave individuale, ndërtimi i infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim dhe rforcimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat).
- Nga Drejtoritë e Përgjithshme janë paraqitur kërkesa për rialokime në buxhetin e vitit 2022 kryesisht në shtim plani për shpenzime operative, ndryshime emërtimesh, investime të reja, studim-projektme dhe oponenta për objekte të reja ndërtimore, etj.
- Detajimin e fondit të shpenzimeve kapitale brenda programit “Rrjetit Rrugor”.

## 2. Shpenzimet sipas programeve

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 i Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:



Siç vihet re, peshën më të madhe në planifikim e zënë:

- Programi i Shërbimet e Publike Vendore (15%)
- Programi i Rrjetit Rrugor Rural (14%)
- Programi i Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor (11%)
- Programi i Planifikim, Menaxhim dhe Administrimit (10%)
- Programi i Panifikimit Urban Vendor (8%)
- Programi Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm (6%)
- Programet e Tjera (36%)

### 3. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Në total, Bashkia Tiranë ka një realizim prej 36% të planit 4-mujor 2023. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

Referuar klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar me 77%,
- Shpenzimet operative me 43% dhe
- Shpenzimet kapitale me 13%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

				në lekë
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në 4M %
<i>Shpenzime personeli</i>	7,940,682,883	2,911,580,433	2,244,594,772	77%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	13,584,417,781	6,919,185,706	2,984,816,312	43%
<i>Shpenzime kapitale</i>	18,430,514,978	7,330,657,115	988,324,627	13%
<b><i>Totali</i></b>	<b>39,955,615,642</b>	<b>17,161,423,254</b>	<b>6,217,735,711</b>	<b>36%</b>


### 4. Shpenzimet sipas burimeve të financimit

Shpenzimet sipas burimeve të financimit për 4-mujor 2023, paraqiten si më poshtë:

					në lekë
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi 4M në %	struktura vjetore
<i>Të ardhura BT</i>	29,763,963,024	9,992,140,082	3,745,456,726	37%	74%
<i>Transferta e Pakushtëzuar +Sektoriale</i>	5,464,028,057	2,733,692,934	984,801,800	36%	14%
<i>Transferta e Pakushtëzuar Rindërtimi</i>	1,846,033,212	1,846,033,212	297,472,094	16%	5%
<i>Transferta e Kushtëzuar</i>	2,573,273,782	2,537,213,782	1,188,668,118	47%	6%

Donacione	57,482,497	36,105,684	1,336,973	4%	0%
TVSH Detyrimi	250,835,070	16,237,560	0	0%	1%
<b>Totali</b>	<b>39,955,615,642</b>	<b>17,161,423,254</b>	<b>6,217,735,711</b>	<b>36%</b>	<b>100%</b>

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i financimit për buxhetin 4-mujor 2023 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 3,745,456,726 lekë e cila përbën 74% të të ardhurave totale faktike. Fondet e Pakushtëzuara dhe Sektoriale zënë 14% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Pakushtëzuara Rindërtimi zënë 5% të burimeve të financimit të planifikuara. Fondet e Kushtëzuara zënë 6% të strukturës së burimeve të financimit, sipas grafikut më poshtë:




#### 4.1 Donacione

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e burimit Donator në bazë programesh:

në Lekë

	Emërtimi	Plan 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	% ndaj planit vjetor	struktura/plani vjetor
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	20,050,898	-	-	0%	35%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	555,000	-	-	0%	1%
04130	Mbështetja për zhvillim ekonomik	28,639,350	28,639,350	-	0%	0%

08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	90,183	90,183	-	0%	0%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	7,376,151	7,376,151	1,336,973	18%	13%
09230	Arsimi I mesëm I përgjithshëm	500,344	-	-	0%	1%
10430	Përkujdesja Sociale	270,571	-	-	0%	0%
	<b>TOTAL</b>	<b>57,482,497</b>	<b>36,105,684</b>	<b>1,336,973</b>	<b>2%</b>	<b>100%</b>



## 5. Shpenzimet sipas klasifikimit në programe

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e shpenzimeve të 4-mujorit 2023 në bazë programesh:

në lekë

	Emërtimi	Plan 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	% ndaj planit 4M	struktura/ plani vjetor
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	4,125,170,181	1,434,883,726	853,803,376	60%	10%
01170	Gjendja Civile	57,533,532	21,473,532	20,301,064	95%	0%
01620	Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore	1,634,400	1,634,400	-	0%	0%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	692,600,000	238,500,000	194,828,887	82%	2%



03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	847,952,940	560,985,192	135,453,236	24%	2%
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	957,165,688	234,880,355	62,985,122	27%	2%
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	413,739,714	165,991,204	72,771,340	44%	1%
04240	Menaxhim I Infrastrukturës se Ujitjes & Kullimit	58,429,015	12,739,002	-	0%	0%
04260	Administrimi I Pyjeve & Kullotave	11,093,502	6,272,534	2,118,000	34%	0%
04520	Rrjeti Rrugor Rural	5,518,514,307	2,042,272,610	482,216,649	24%	14%
04570	Transporti Publik	801,913,028	382,035,268	141,272,641	37%	2%
05100	Menaxhim I Mbetjeve	2,046,480,901	947,207,229	523,663,661	55%	5%
06140	Planifikim Urban Vendor	3,249,831,325	1,575,385,115	157,395,852	10%	8%
06190	Strehimi	125,385,600	125,385,600	124,486,600	99%	0%
06210	Programet e Zhvillimit	670,519,607	670,519,607	255,693,649	38%	2%
06220	Menaxhimi I mbetjeve urbane	200,000,000	200,000,000	114,658,366	57%	1%
06260	Shërbimet Publike Vendore	5,998,539,067	1,966,207,053	703,377,292	36%	15%
08130	Sport dhe Argëtim	772,655,775	361,628,970	139,313,785	39%	2%
08220	Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	827,617,451	378,881,092	168,733,222	45%	2%
08230	Arti dhe Kultura	448,039,000	448,039,000	-	0%	1%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	4,239,489,657	2,151,962,799	707,256,798	33%	11%
09230	Arsimi I mesëm I përgjithshëm	2,371,988,335	981,654,732	324,454,430	33%	6%
09240	Arsimi Profesional	26,483,760	26,483,760	-	0%	0%
10430	Përkujdesje Sociale	1,732,047,941	1,503,160,150	927,890,157	62%	4%
10661	Strehimi Social	2,066,794,326	198,987,834	70,878,008	36%	5%
10910	Emergjencia Civile	284,252,490	284,252,490	34,183,576	12%	1%
04910	Fondi Rezervë	1,369,744,100	235,000,000	-	0%	3%
04940	Fondi I Kontigjencës	40,000,000	5,000,000	-	0%	0%
	<b>TOTAL</b>	<b>39,955,615,642</b>	<b>17,161,423,254</b>	<b>6,217,735,711</b>	<b>36%</b>	<b>100%</b>

- **Programi Shërbimet Publike Vendore** i cili përbën 15% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 36% të 4-mujorit 2023.
- **Programi Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor** i cili përbën 11% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 33% të 4-mujorit 2023.
- Programi Rjeti Rrugor** i cili përbën 14% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 24% të 4-mujorit 2023.
- Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim** i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 60% të 4-mujorit 2023.
- Programi Planifikimi Urban Vendor** i cili përbën 8% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 10% të 4-mujorit 2023.
- Programi Përkujdesje Sociale** i cili përbën 4% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 62% të 4-mujorit 2023.
- Programi Shërbimet e Policise Vendorei** i cili përbën 2% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 82% të 4-mujorit 2023

## 6. Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik

Shpenzimet korente dhe kapitale për çdo funksion sipas programeve dhe nga të gjitha burimet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

		SHPENZIME KORENTE			SHPENZIME KAPITALE		
	Emërtimi	Plan 4M 2023	Fakti 4M 2023	%	Plan 4M 2023	Fakti 4M 2023	%
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	1,285,917,256	851,801,776	66%	148,966,470	2,001,600	1%
01170	Gjendja Civile	21,473,532	20,301,064	0%	-	-	0%
01620	Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore	1,634,400	-	0%	-	-	0%
03140	Shërbimet e Policise Vendore	213,500,000	194,828,887	91%	25,000,000	-	0%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	481,733,258	90,293,892	19%	79,251,934	45,159,344	57%
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	66,128,571	28,059,673	42%	168,751,784	34,925,449	21%
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	97,260,836	59,867,872	62%	68,730,368	12,903,468	19%
04240	Menaxhim I Infrastrukturës se Ujitjes & Kullimit	12,739,002	-	0%	-	-	0%
04260	Administrimi I Pyjeve & Kullotave	6,272,534	2,118,000	34%	-	-	0%
04520	Rrjeti Rrugor Rural	498,968,973	303,384,134	61%	1,543,303,637	178,832,515	12%
04570	Transporti Publik	292,840,000	111,783,633	38%	89,195,268	29,489,008	33%
05100	Menaxhim I Mbetjeve	947,207,229	523,663,661	55%	-	-	0%
06140	Planifikim Urban Vendor	134,045,963	66,368,663	50%	1,441,339,152	91,027,189	6%
06190	Strehimi	125,385,600	124,486,600	99%	-	-	0%

06210	Programet e Zhvillimit				670,519,607	255,693,649	38%
06220	Menaxhimi I mbetjeje urbane	200,000,000	114,658,366	57%			0%
06260	Sherbimet Publike Vendore	665,064,000	437,998,627	66%	1,301,143,053	265,378,665	20%
08130	Sport dhe Argëtim	344,339,065	136,532,605	40%	17,289,905	2,781,180	16%
08220	Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	319,923,298	163,923,763	0%	58,957,794	4,809,459	8%
08230	Arti dhe Kultura	-	-	0%	448,039,000	-	0%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	1,221,993,638	651,270,671	53%	929,969,161	55,986,127	6%
09230	Arsimi I mesëm I përgjithshëm	646,654,750	315,117,456	49%	334,999,982	9,336,974	3%
09240	Arsimi Profesional	26,483,760	-	0%	-	-	0%
10430	Përkujdesje Sociale	1,497,960,150	927,890,157	62%	5,200,000	-	0%
10661	Strehimi Social	198,987,834	70,878,008	36%	-	-	0%
10910	Emergjencia Civile	284,252,490	34,183,576	12%	-	-	0%
04910	Fondi Rezervë	235,000,000	-	0%	-	-	0%
04940	Fondi I Kontigjencës	5,000,000	-	0%	-	-	0%
	<b>TOTAL</b>	<b>9,830,766,139</b>	<b>5,229,411,084</b>	<b>53%</b>	<b>7,330,657,115</b>	<b>988,324,627</b>	<b>13%</b>

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat duke iu referuar Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2023 - 2025 të miratuar me VKB nr. 126, datë 23.12.2022 dhe në vazhdim, planit për buxhetin vjetor të miratura me këtë vendim, si dhe për këtë periudhë planin dhe faktin 4-mujorit 2023. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, TVSH Detyrime, Transferten e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Transfera e Pakushtëzuar Rindërtimi

në lekë

	Emërtimi	PBA fillestar 2023	Plan i rishikuar 2023	Plani 4 M 2023	Fakti 4 M 2023
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	3,736,812,209	4,125,170,181	1,434,883,726	853,803,376
03140	Shërbimet e Policise Vendore	694,844,000	692,600,000	238,500,000	194,828,887
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	339,967,888	847,952,940	560,985,192	135,453,236
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	346,954,353	957,165,688	234,880,355	62,985,122
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	390,973,978	413,739,714	165,991,204	72,771,340
04240	Menaxhim I Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit	23,023,822	58,429,015	12,739,002	-
04260	Administrimi I Pyjeve & Kullotave	10,713,262	11,093,502	6,272,534	2,118,000
04520	Rrjeti Rrugor	4,032,890,557	5,518,514,307	2,042,272,610	482,216,649
04570	Transporti Publik	544,043,228	801,913,028	382,035,268	141,272,641

05100	Menaxhim I Mbetjeve	1,934,948,672	2,046,480,901	947,207,229	523,663,661
06140	Planifikim Urban Vendor	2,355,487,038	3,249,831,325	1,575,385,115	157,395,852
06210	Programet e Zhvillimit	-	670,519,607	670,519,607	255,693,649
06260	Shërbimet Publike Vendore	5,594,573,349	5,998,539,067	1,966,207,053	703,377,292
08130	Sport dhe Argëtim	595,421,195	772,655,775	361,628,970	139,313,785
08220	Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	569,999,850	827,617,451	378,881,092	168,733,222
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	3,154,982,483	4,173,671,407	2,086,144,549	688,924,804
09230	Arsimi I mesëm I përgjithshëm	1,767,211,454	2,358,750,585	968,416,982	315,297,560
10430	Përkujdesja Sociale	356,682,820	381,158,941	152,271,150	60,340,509
10661	Strehimi Social	1,983,346,492	2,066,794,326	198,987,834	70,878,008
04910	Fondi Rezervë	300,000,000	1,369,744,100	235,000,000	-
04940	Fondi I Kontigjencës	40,000,000	40,000,000	5,000,000	-
	<b>TOTAL</b>	<b>28,772,876,650</b>	<b>37,382,341,860</b>	<b>14,624,209,472</b>	<b>5,029,067,593</b>

Në tabelën më poshtë paraqiten fonde të transferuara gjatë kësaj periudhe për Bashkinë Tiranë si rezultat i funksioneve të deleguara për këtë periudhë 4-mujorit 2023. Këtu përfshihen fonde që janë deleguar nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministrive të linjës për funksionet e deleguara për:

- Gjendjen Civile
- Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore
- Ndhmën Ekonomike
- Ndihmë për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Kuota për shërbime të ndryshme sociale, Bursa
- Transferime
- Projekte të reja arsimore e kulturore

në lekë

	Emertimi	Plan 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	%
01170	Gjendja Civile	57,533,532	21,473,532	20,301,064	35%
01620	Administrimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore	1,634,400	1,634,400	-	0%
06190	Strehimi	125,385,600	125,385,600	124,486,600	99%
06220	Menaxhimi I mbetjeve urbane	200,000,000	200,000,000	114,658,366	57%
08230	Arti dhe Kultura	448,039,000	448,039,000	-	0%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	65,818,250	65,818,250	18,331,994	28%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	13,237,750	13,237,750	9,156,870	69%

09240	Arsimi Profesional	26,483,760	26,483,760	-	0%
10430	Përkujdesja Sociale	1,350,889,000	1,350,889,000	867,549,648	64%
10910	Emergjenca Civile	284,252,490	284,252,490	34,183,576	12%
	<b>TOTAL</b>	<b>2,573,273,782</b>	<b>2,537,213,782</b>	<b>1,188,668,118</b>	<b>46%</b>

## 7. Fondi i Rezervës dhe Fondi i Kontigjencës

Fondi Rezervë për periudhën Janar –Prill 2023, është përdorur si mëposhtë:

VKB nr.23, datë 17.03.2023 “Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.126, datë 23.12.2022, të këshillit bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 2023 ”, në shumën 1,069,744,100 lekë.

Nga Fondi i Kontigjencës përgjatë periudhës Janar-Prill 2023 nuk ka pasur përdorim fondi.

# KAPITULLI II

## \*MONITORIMI

### I

## SHPENZIMEVE DHE PRODUKTEVE SIPAS PROGRAMEVE

### 1. Programi “Planifikim, Menaxhim & Administrim”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 60%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 93%
- Shpenzime të tjera operative 38%
- Shpenzime kapitale 1%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	2,033,881,245	654,979,245	610,318,586	93%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	1,639,497,155	630,938,011	241,483,190	38%
<i>Shpenzime kapitale</i>	451,791,781	148,966,470	2,001,600	1%
<b>Totali</b>	<b>4,125,170,181</b>	<b>1,434,883,726</b>	<b>853,803,376</b>	<b>60%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objektivi I i këtij programi është: Rritja e kapaciteteve të vazhdueshme të stafit. Përmirësimi, motivimi dhe angazhimi i punonjësve të administratës. Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë së Tiranës dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: "Trajnim dhe Zhvillim i Stafit të Bashkisë Tiranë" për 4-mujorin 2023 është planifikuar 3,000,000 lekë dhe është realizuar 0% e planit 4-mujor. Për vitin 2023 janë planifikuar të trajnohen 680 punonjë në Bashkinë e Tiranës.

Produkti 2: "Ri-optimizimi dhe Standartizimi i proceseve të punës së strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë" për 4-mujorin 2023 është planifikuar 10,000,000 lekë, deri tani nuk ka patur realizim. Nëpërmjet këtij produkti kërkohet të maksimizohet struktura me të cilën funksionon institucioni i Bashkisë Tiranë dhe në të njëjtën kohë të trajnohen stafet që i përdorin këto procese, të rritet efienca organizative duke i përmirësuar këto procese nëpërmjet eliminimit të proceseve që zgjasin shërbimet në kohë, mirëpërcaktimin e mbarëvajtjes së punës, përmirësimin e komunikimit ndërmjet drejtorive dhe parashikimin e ndryshimeve. Në të njëjtën kohë synohet të arrihet përafrimi me Standartet e Bashkimit Europian dhe përcaktimin e të gjitha elementeve ligjore që mund të kënë nevojë për përmirësim.

Objektivi II i këtij programi është: Rritja e transparencës dhe imazhit të Bashkisë Tiranë kundrejt përthithjes së kandidatëve për t'u rekrutuar si nëpunës civilë dhe praktikantëve për të siguruar një edukim sa më të mirë të qytetarëve me tregun e punës dhe përfitimin e krahëve shtesë të forcës punëtore në Bashki në mënyrë eficiente. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti "Fillo me një ide, fito një praktikë pune në Bashkinë Tiranë" për 4-mujorin 2023 është planifikuar 2,163,000 lekë dhe nuk ka patur realizim për 4 mujorin.

Produkti 2: Panairi i Punës për 4-mujorin 2023 është planifikuar 1,000,000 lekë dhe nuk është realizuar ende plani 4 mujor.

Produkti 3: Projekti "Web-Challenge Tirana" për 4-mujorin 2023 është planifikuar 1,400,000 lekë dhe nuk ka patur realizim për planin 4 mujor. Ky projekt lindi si nevojë e kërkesave të të rinjve për të marrë pjesë në ndërtimin e websiteve dhe fushës së dizajnit gjatë panairit të punës. Nën mbikqyrjen e Drejtorisë së Trajnimit dhe Zhvillimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe të Dhënave, të rinjtë do të konkurojnë me idetë e tyre ku do të trajnohen dhe do të vlerësohen me një internship 3 mujor dhe vlerë monetare përgjatë projektit.

Objektivi III i këtij programi është: “Shërbime të përgjithshme publike, administrim, funksionim dhe ofrim i shërbimeve të mbështetjes për aparatin e Bashkisë Tiranë”. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: “Shërbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucionet e tjera të Bashkisë Tiranë”, është parashikuar 98,400,000 lekë dhe është realizuar 37% e planit 4 mujor.

Objektivi IV i këtij programi është: “Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likujdojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor. Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit.” Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023 është realizuar produkti me të dhëna si më poshtë:

Produkti 1: Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor nëpërmjet informimit, për 64,735 tatim pagues aktivë, janë shpenzuar 6,865,708 lekë nga 36,548,000 lekë të planifikuar për vitin 2023.

## 2. Programi “Shërbimet e Policisë Vendore”

Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 82%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit	98%
- Shpenzime të tjera operative	18%
- Shpenzime kapitale	0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	609,790,000	195,690,000	191,618,287	98%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	30,310,000	17,810,000	3,210,600	18%
<i>Shpenzime kapitale</i>	52,500,000	25,000,000	-	0%
<b>Totali</b>	<b>692,600,000</b>	<b>238,500,000</b>	<b>194,828,887</b>	<b>82%</b>



Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Investimet për programin Shërbimet e Policisë Vendore për vitin 2023 janë 10 projekte / investime që menaxhohen nga Institucioni që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 25,000,000 lekë për 4-mujorin 2023 dhe nuk ka patur realizim për 4-mujorin.

### 3. Programi “Mbrotjtja nga Zjarri & Mbrotjtja Civile”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë për Mbrotjtjen nga Zjarri dhe Emergjencën Civile.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 24%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit      | 49% |
| - Shpenzime të tjera operative | 11% |
| - Shpenzime kapitale           | 57% |

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
Shpenzime personeli	199,447,301	100,715,000	49,420,702	49%
Shpenzime të tjera operative	478,524,677	381,018,258	40,873,190	11%
Shpenzime kapitale	169,980,962	79,251,934	45,159,344	57%
<b>Totali</b>	<b>847,952,940</b>	<b>560,985,192</b>	<b>135,453,236</b>	<b>24%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Demolim dhe evadim i mbetjeve ndërtimore në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 2,919,000 lekë për 4-mujorin 2023, dhe nuk ka patur realizim për 4-mujorin.
- Investimet për programin e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile për vitin 2023 përbëhet nga 15 projekte/investime të Emergjencës Civile me një realizim 45,159,344 lekë dhe 2 projekte/investime të Mbrojtjes nga Zjarri që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion.

#### 4. Programi “Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik”


Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë dhe Agjencia e Administrimit të Tregjeve,

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 27%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 98%
- Shpenzime të tjera operative 29%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë				
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
Shpenzime personeli	41,770,000	13,322,000	12,777,660	96%
Shpenzime të tjera operative	100,069,195	52,806,571	15,282,013	29%
Shpenzime kapitale	815,326,493	168,751,784	34,925,449	0%
<b>Totali</b>	<b>957,165,688</b>	<b>234,880,355</b>	<b>62,985,122</b>	<b>27%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 4-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 234,880,355 lekë për 4-mujorin 2023.

Objektivi I i këtij programi është: Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik Brenda territorit të njësisë vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja të gjelbërta të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta”

duke future element go-green në to” për 4-mujorin 2023 është planifikuar 6,500,000 lekë dhe nuk ka patur realizim për 4 mujorin.

Objektivi II i këtij programi është: Projekte që kanë për qëllim promovimin e turizmit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Turizmi për 4-mujorin 2023 është planifikuar 5,655,000 lekë dhe është realizuar 8% e planit 4 mujor.

Objektivi III i këtij programi është: Të hartojë, zbatojë dhe monitorojë politika të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Programi ReLOaD për 4-mujorin 2023 është planifikuar dhe është realizuar % e planit 4 mujor.

## 5. Programi “Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 44%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 87%
- Shpenzime të tjera operative 19%
- Shpenzime kapitale 19%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	190,900,000	60,932,000	52,921,015	87%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	88,997,730	36,328,836	6,946,857	19%
<i>Shpenzime kapitale</i>	133,841,984	68,730,368	12,903,468	19%
<b>Totali</b>	<b>413,739,714</b>	<b>165,991,204</b>	<b>72,771,340</b>	<b>44%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 4-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Objektivi I i këtij programi është: Iniciativë për të nxitur prezantimin dhe promovimin e produkteve lokale dhe rurale. Për arritjen e këtij objektivi për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: TiranAgro është projekti i cili do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të panairit vjetor, ku do të promovohen produktet bujqësore dhe blegtorale si: vreshtaria, bulmeti, mjalti, frutat e egra, bimët medicinale, etj., si dhe artizanët dhe prodhimet e tyre. Ky projekt do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë Administrative Rurale, Drejtori të ndryshme të Bashkisë Tiranë, si dhe shoqatat të cilat operojnë në fushën e artizanatit.

Objektivi II i këtij programi është: Hartimi i planeve të reja të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkisë Tiranë për të evidentuar gjendjen aktuale të fondit pyjor e kullësor, plane të cilat parashikojnë masat që duhen të ndërmerren në 10-vjeçarim e ardhshëm. Për arritjen e këtij objektivi për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon

Produkti 1: Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Vërrit dhe Vorës. Ky projekt synon të përmirësojë menaxhimin e fondit pyjor dhe kullësor nëpërmjet vendosjes së rregullave të qarta për shfrytëzimin dhe përdorimin racional të pyjeve dhe kullotave.

Objektivi III i këtij programi është: Inspektimi dhe shërbimet për qytetarët, administrimi i thertores publike, si dhe mbrojtja e trajtimi i kafshëve endacake. Për arritjen e këtij objektivi për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të tjera janë realizuar 3,716 kontrolle për 4 mujorin 2023. Shpenzimet faktike për këtë produkt janë 5,472,783 lekë.

Produkti 2: Trajtimi i ankesave të qytetarëve. Gjatë katër mujorit të parë numri i ankesave të trajtuara është 530.

## 6. Programi “Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”


Ky program menaxhohet nga Aparati Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale)

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 0%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	23,099,722	12,739,002	-	0%
<i>Shpenzime kapitale</i>	35,329,293	-	-	0%
<b><i>Totali</i></b>	<b>58,429,015</b>	<b>12,739,002</b>	<b>-</b>	<b>0%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



## 7. Programi “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave”

Ky program menaxhohet nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me fonde nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 34%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 34%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	11,093,502	6,272,534	2,118,000	34%
<b><i>Totali</i></b>	<b>11,093,502</b>	<b>6,272,534</b>	<b>2,118,000</b>	<b>34%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



## 8. Programi “Rrjeti Rrugor Rural”

Ky program është në funksion të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve në zonat urbane dhe rurale. Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 24%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 97%
- Shpenzime të tjera operative 47%
- Shpenzime kapitale 12%

				në lekë
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	428,329,740	136,729,740	133,271,774	97%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	871,456,384	362,239,233	170,112,360	47%
<i>Shpenzime kapitale</i>	4,218,728,183	1,543,303,637	178,832,515	12%
<b>Totali</b>	<b>5,518,514,307</b>	<b>2,042,272,610</b>	<b>482,216,649</b>	<b>24%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:





Objektivi i këtij programi është: Rehabilitimin e rrugëve të Tiranës, ku përcaktohen dëmtime në rrugë, trotuare dhe bordure, në bazë të inventarizimit të rrugëve dhe verifikimit në terren të tyre; Zgjerimi i mbulimit të territorit të qytetit me transport publik; Ndërtimi i terminaleve të transportit multifunksional; Kontraktimi i Shoqërive Private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produkte me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Rikonstruksioni i rrugës “Grigor Cilka”, e cila ndodhet në zonën e senatoriumit në Nj.A. nr.2. Realizimi i tij parashikon ndërhyrjen në këtë rrugë dhe degëzimet e saj duke ndërtuar shtresa rrugore, trotuare, rrjete inxhinierike, ndriçim publik, etj. Vlera e planifikuar për këtë për vitin 2023 është 24,181,346 lekë.

Produkti 2: Rikonstruksioni i rrugës “At Stath Melani”, e cila ndodhet në Nj.A. nr.6 dhe parashikohet rikonstruksioni i të gjithë aksit. Vlera e planifikuar për këtë për vitin 2023 është 22,256,570 lekë.

Produkti 3: Ndërtimi i rrugës nga kryqëzimi i Unazës së Madhe me rrugën “Nexho Konomi” në drejtim të lumit Lana, e cila ndodhet në Nj.A. nr.7 dhe parashikohet ndërtimi i plotë i shtresave rrugore, rrjetet inxhinierike, ndriçimi publik, sinjalistika dhe gjelbërimi në të dy krahet në trotuare. Vlera e planifikuar për këtë për vitin 2023 është 16,166,843 lekë.

## 9. Programi “Transporti Publik”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë si dhe Tirana Parking si institucion varësie.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 37%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit	89%
- Shpenzime të tjera operative	29%
- Shpenzime kapitale	33%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	140,182,312	44,682,312	39,815,367	89%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	505,692,220	248,157,688	71,968,266	29%
<i>Shpenzime kapitale</i>	156,038,496	89,195,268	29,489,008	33%
<b>Totali</b>	<b>801,913,028</b>	<b>382,035,268</b>	<b>141,272,641</b>	<b>37%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Projekte të ndryshme që sigurojnë mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti i monitorimit, menaxhimit dhe kontrollit të transportit publik qytetës, nëpërmjet sistemeve inteligjente të transportit (AVL), në nivel qendror dhe lokal, si edhe sistemeve të informacioneve në kohë reale për pasagjerët (RTIP), për disa nga stacionet kryesore.

Produkti 2: Subvencion për shërbimin e transportit publik qytetës në Bashkinë e Tiranës. Plani i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 102,000,000 lekë, për këtë periudhë është realizuar 56,787,885 lekë ose 56% e planit 4-mujor.

Produkti 3: Projekti i GPS-së në Transportin Publik të qytetit është një projekt. Plani i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 122,580,000 lekë, për këtë periudhë raportimi nuk ka realizim për këtë produkt.

Objektivi II i këtij programi është: Shtimi i blloqeve rezident në qytetin e Tiranës me qëllim rritjen e kapaciteteve të parkimit të qytetarëve. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produkte me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mirëmbajtja e sipërfaqeve të shesheve të parkimit në total gjatë viti 2023 janë 51829 m<sup>2</sup> të cilat mirëmbahen nga institucioni i varësisë Tirana Parking. Buxheti i planifikuar për këtë vit është në vlerën 182,250,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 29% të vlerës ose në vlerën 52,059,000 lekë.

Produkti 2: Mirëmbajtja e sistemeve të parkimeve dhe pastrimi, buxheti për vitin 2023 është në vlerën 18,050,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 9% ose në vlerën 1,706,000 lekë.

## 10. Programi “Menaxhim i Mbetjeve”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 55%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 55%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	2,046,480,901	947,207,229	523,663,661	55%
<b><i>Totali</i></b>	<b>2,046,480,901</b>	<b>947,207,229</b>	<b>523,663,661</b>	<b>55%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; Ndarjen e diferencuar të plehrave brenda unazës së mesme. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shpenzime për Ndërtimin e Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike. Plani i planifikuar është në vlerën 264,373,700 lekë nga të cilat janë realizuar 127.189.167 lekë ose 48% e vlerës së planit.

Objektivi II i këtij programi është: Rikonceptimin, strukturimin, përmirësimin e frekuencës së pastrimit të zonave dhe shërbimeve të pastrimit të qytetit në Bashkinë e Tiranës së re Administrative në zonat urbane dhe rurale. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Pastrimi i Qytetit. Plani i planifikuar është në vlerën 631,733,529 lekë nga të cilat janë realizuar 396,474,494 lekë ose 63% e vlerës së planit.

Objektivi III i këtij programi është: Përcaktimi i politikave për zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë (GES), për përshtatjen me ndryshimet klimatike, për mbrojtjen e natyrës, si dhe synimet afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit dhe larmisë së peizazhit, vlerave të mbrojtura të natyrës, për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, për të orientuar autoritetet vendore drejt masave praktike dhe veprimeve në lidhje me grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve, sistemet e riciklimit dhe impiantet që lidhen me to, për promovimin e mënyrave alternative dhe miqësore me mjedisin. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Hartim i Planit të veprimit për Ndryshimet Klimatike, i cili synon analizimin e situatës në të cilën gjendet Bashkia Tiranë lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit për uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike me synim zbutjen e efekteve të dëmshme të ndryshme klimaterike. Plani i planifikuar është në vlerën 5,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Produkti 2: Hartim i Planit të veprimit ndaj Emergjencave Civile synon organizimin dhe bashkërendimin e autoriteteve shtetërore, të strukturave të qeverisjes vendore, të subjekteve private dhe të çdo pale tjetër të prekur brenda territorit të administruar nga Bashkia Tiranë, për parandalimin dhe përballimin e situatave të shkaktuara nga ndodhja e një fatkeqësie natyrore. Plani i planifikuar është në vlerën 5,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Produkti 3: Hartim i Planit të veprimit Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore. Plani i planifikuar është në vlerën 5,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Produkti 4: Hartim i Planit të Veprimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e Biodiversitetit dhe Vlerësimit Mjedisor Strategjik i Hapësirave të Gjelbra (Plani i Veprimit Qyteti i Gjelbër) synon analizimin e situatës në të cilën gjendet Bashkia Tiranë lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit për ruajtjen dhe përmirësimin e diversitetit biologjik dhe pejsazhor të vendit, dhe përfshirjen e parimeve dhe politikave të përdorimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të tij në sektorë të tjerë, me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Plani i planifikuar është në vlerën 5,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Produkti 5: Hartim i Planit të Veprimit të Menaxhimit Vendor të Mbetjeve mundëson zbatimin e politikës kombëtare për mbetjet në nivel vendor. Qëllimi është të orientojë veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me zbatimin e të gjithë hallkave të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, krijimin e instrumentave institucionale-organizative, rregullatore dhe efikase që rekomandojnë masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij dhe përputhshmërinë me standartet më të mira të menaxhimit të mbetjeve. Plani i planifikuar është në vlerën 5,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Produkti 6: Plan Vendor i Veprimit për Ndotjen Akustike ka si qëllim analizimin e situatës në të cilën gjendet Bashkia Tiranë lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit për mbrojtjen nga zhurmat, vlerësimin e shqetësimeve të komunitetit dhe të bizneseve lidhur me zhurmat. Objektivi kryesor i Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit mbi Zhurmat është 5-vjeçar 2023-2027 me një parashikim prej 70,000,000 lekë. Ketu i referohemi kërkesës për buxhet për periudhën 3- vjeçare, 2023-2025 me një parashikim prej 50,000,000 lekë.

Produkti 7: Projekte Mjedisore synon të ideojë dhe realizojë projekte konkrete që kanë të bëjnë me ndërgjegjësimin mjedisor, duke promovuar metodat alternative të lëvizshmërisë miqësore me mjedisin, solidarizimin me nismat ndaj ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike dhe çështjeve të tjera mjedisore. Plani i planifikuar është në vlerën 21,100,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

## **11. Programi “Planifikimi Urban Vendor”**


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit. Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 10%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit	89%
- Shpenzime të tjera operative	13%
- Shpenzime kapitale	6%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
Shpenzime personeli	201,800,000	64,628,000	57,615,048	89%
Shpenzime të tjera operative	176,417,963	69,417,963	8,753,615	13%
Shpenzime kapitale	2,871,613,362	1,441,339,152	91,027,189	6%
<b>Totali</b>	<b>3,249,831,325</b>	<b>1,575,385,115</b>	<b>157,395,852</b>	<b>10%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objekti I i këtij programi është: Mirëadministrimin e çdo çështjeje që lidhet me rritjen e efijencës së jetës së komunitetit në funksion të gjithëpërfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Fondi i Komuniteteve, për të cilin është planifikuar plani në vlerën prej 46,417,963 lekë nga të cilat është realizuar 5,777,007 lekë ose 12% e planit 4-mujor.

## 12. Programi “Programet e Zhvillimit”

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 38%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime kapitale 38%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime kapitale</i>	670,519,607	670,519,607	255,693,649	38%
<b><i>Totali</i></b>	<b>670,519,607</b>	<b>670,519,607</b>	<b>255,693,649</b>	<b>38%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



### 13. Programi “Shërbime Publike Vendore”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe institucionet e varësisë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik
- Agjencia e Shërbimeve Funerale

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 36%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime personeli 91%
- Shpenzime të tjera operative 45%
- Shpenzime kapitale 20%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	944,619,372	302,383,372	274,296,090	91%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	868,917,958	362,680,628	163,702,537	45%
<i>Shpenzime kapitale</i>	4,185,001,737	1,301,143,053	265,378,665	20%
<b>Totali</b>	<b>5,998,539,067</b>	<b>1,966,207,053</b>	<b>703,377,292</b>	<b>36%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Rikualifikimi i hapësirave publike, rehabilitim i sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese, shtim i ambienteve shplohëse dhe argëtuese. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Rikualifikim blloku që kufizohet nga rrugët Minella Karajan – Unaza e Madhe – Ali Hafizi Ulqinaku vlera e planifikuar për vitin 2023 është 18,990,956 lekë.



Produkti 2: Rijetësimi “Lagjia e artistëve” vlera e planifikuar për vitin 2023 është 13,474,656 lekë.

Produkti 3: Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rruga “Mine Peza”- “Fortuzi”-“Zogu I”- “Haxhi Hysen Dalliu”- “Asim Vokshi” vlera e planifikuar është 57,537,458 lekë.

Produkti 4: Rikualifikim i bllokut te tregu Cam vlera e planifikuar për ndërtim-montim, mbikëqyerje punimesh dhe kolaudim është në vlerë 18,224,637 lekë.

Objektivi II i këtij programi është: Administrimi dhe organizimi i shërbimeve funerale, pastrimi mirëmbajtja dhe ruajtja e varrezave publike. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe për mirëmbajtjen totale të varrezave në total janë 502,070 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të cilat duhen të mirëmbahen gjatë viti 2023, buxheti i planifikuar për këtë produkt për vitin 2023 është 165,800,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 8% ose 42,569,115 lekë.

#### 14. Programi “Sport dhe Argëtim”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe insitucionet e varësisë si më poshtë:

- Agjencia e Rinisë
- Klubi Sportiv “Tirana”
- Klubi shumësportësh “Partizani”
- Klubi Sportiv “Studenti”


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 39%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 69%
- Shpenzime të tjera operative 36%
- Shpenzime kapitale 16%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	88,618,570	34,702,765	24,113,961	69%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	663,897,300	309,636,300	112,418,644	36%
<i>Shpenzime kapitale</i>	20,139,905	17,289,905	2,781,180	16%
<b><i>Totali</i></b>	<b>772,655,775</b>	<b>361,628,970</b>	<b>139,313,785</b>	<b>39%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Ky program është në funksion të krijimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave sportive dhe organizimit të aktiviteteve për rininë.

Për 4-mujorin 2023 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Objektivi I i këtij programi është: Mbështetje për projekte të ndryshme sportive. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Sportive. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 64,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 13,696,625 lekë ose 21% e planit 4-mujor.

Objektivi II i këtij programi është: Mbështetje për projektet rinore që do të organizohen në Tiranë dhe rrethina në bashkëpunim edhe me shoqata të ndryshme. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Rinore. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 8,857,500 lekë nga të cilat është realizuar 5,417,500 lekë ose 61% e planit 4-mujor.

Objektivi III i këtij programi është: Organizimi dhe koordinimi i veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve, për të mbështetur mirëqënien dhe zhvillimin e të rinjve, zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore; bashkëpunimin me organizatat vendase dhe të huaja; nxitjen, vlerësimin dhe promovimin e aftësive të

studentëve në fusha të ndryshme shoqërore si arti, kultura, edukimi, sporti, etj. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Biletë e pajtimit mujor të përgjithshëm (Abone Studenti) për studentët e pajisur me kartë student për të gjitha linjat në transportin qytetës në Bashkinë e Tiranës. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 48,628,800 lekë nga të cilat është realizuar 39,062,400 lekë ose 80% e planit 4-mujor.

### 15. Programi “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe insitucionet e varësisë si më poshtë:

- Qendra Rinore TEN
- Qendra Kulturore Tirana
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Kadare"
- Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tiranë
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Agolli"
- Galeria e Artit Tirana
- Agjensia e Industrisë Kreative


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 45%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- |                                |     |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit      | 94% |
| - Shpenzime të tjera operative | 45% |
| - Shpenzime kapitale           | 8%  |

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	133,500,000	43,058,000	40,646,087	94%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	573,085,298	276,865,298	123,277,676	45%
<i>Shpenzime kapitale</i>	121,032,153	58,957,794	4,809,459	8%
<b>Totali</b>	<b>827,617,451</b>	<b>378,881,092</b>	<b>168,733,222</b>	<b>45%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Ky program është në funksion të krijimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së projekteve / ambienteve kulturore dhe artistike. Objektivi I i këtij programi është: Mbikqyrja dhe rregullimi i strukturave kulturore. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Ndërtimi i shtigjeve në disa objekte historike kulturore, synon nxitjen e ecjes në natyrë dhe zhvillimin e turizmit historik e kulturor.

Objektivi II i këtij programi është: Rivitalizimi i objekteve historike e kulturore me forma të ndryshme të kreativitetit si shprehje e identitetit të kryeqytetit; Të ofrojë sa më shumë aktivitete, të cilat lidhen me programin e kulturës dhe të artit, për t'i paraqitur në Këshillin Artistiko-Kulturor, të ardhura pranë Bashkisë Tiranë, duke parë mundësitë më të mira për shtimin e impaktit. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Kulturore, të cilat do të organizohen në Tiranë dhe rrethinat e saj në bashkëpunim me shoqata të ndryshme. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 80,515,450 lekë nga të cilat është realizuar 73,532,335 lekë ose 91% e planit 4-mujor.

## 16. Programi “Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe institucionet e varësisë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
- Shkolla “Luigj Gurakuqi”.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 33%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 59%
- Shpenzime të tjera operative 45%
- Shpenzime kapitale 6%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	1,829,299,269	789,235,374	468,949,318	59%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	899,979,196	366,940,014	163,989,359	45%
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,444,392,942	929,969,161	55,986,127	6%
<b><i>Totali</i></b>	<b>4,173,671,407</b>	<b>2,086,144,549</b>	<b>688,924,804</b>	<b>33%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Mirërritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve duke ofruar për fëmijët e çrdhes kujdes edukativ, shëndetësor, psikosocial dhe ushqim, ndërsa për fëmijët e kopshteve dhe çerdheve koordinim të kujdesit shëndetësor dhe ushqim. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Stimulim i nxënësve me dhjeta. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 63,250,000 lekë nga të cilat është realizuar 45,000 lekë.

## 17. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe institucionet e varësisë si më poshtë:


- Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike
- Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 33%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 58%
- Shpenzime të tjera operative 32%
- Shpenzime kapitale 3%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	në lekë
				Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	879,345,074	398,586,625	231,345,173	58%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	545,107,435	234,830,375	74,615,413	32%
<i>Shpenzime kapitale</i>	934,298,076	334,999,982	9,336,974	3%
<b>Totali</b>	<b>2,358,750,585</b>	<b>968,416,982</b>	<b>315,297,560</b>	<b>33%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi i këtij programi është: Rritje e kapacitetit të nxënësve dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimit të ofruar në konvikte. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti: Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte janë 236 nxënës për këtë 4-mujor të vitit 2023. Për këtë vit janë planifikuar të akomodohen 300 nxënës, buxheti i shpenzuar është në vlerën 33,238,705 lekë nga 141,905,622 lekë të planifikuar.

### 18. Programi “Përkujdesja Sociale”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe institucionet e varësisë si më poshtë:

- Qendra Komunitare “Për persona me aftësi të kufizuar”
- Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”
- Qendra Komunitare “Shkozë”
- Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”
- Qendra Komunitare e Terrenit
- Qendra Komunitare Multidisiplinare

- Qendra Sociale “Strehëza”.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 40%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime page 75%
- Shpenzime të tjera operative 22%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	164,500,000	53,296,000	40,018,000	75%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	201,565,121	93,775,150	20,322,509	22%
<i>Shpenzime kapitale</i>	15,093,820	5,200,000	-	0%
<b>Totali</b>	<b>381,158,941</b>	<b>152,271,150</b>	<b>60,340,509</b>	<b>40%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I për këtë program është: Zgjerimi dhe mundësimi i projekteve të kujdesit social me focus shtresat dhe kategoritë në nevojë me qëllim mbulimin me shërbime sociale të karaktereve të ndryshme inovative. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mbështetje Sociale në Shërbime për kategoritë në nevojë. Ky program synon të përmirësojë cilësinë e jetesës së kategorive në nevojë, përmban projekte dhe përkujdesje në realizimin e këtyre projekteve inovative me karakter social që kanë në fokus: fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi



ndryshe, të moshuarit në nevojë, fuqizimin social dhe stabilitetin ekonomik të gruas kryefamiljare dhe grave në nevojë nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të përkujdesjes sociale të mundësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë.

Objektivi II për këtë program është: Sigurimi i shërbimeve sociale kryesisht Rom, duke i mbrojtur nga të gjitha format e shfrytëzimit, duke garantuar përmbushjen e nevojave të tyre parësore dhe integrimin e tyre në shoqëri përmes ofrimit të shërbimeve multidimensionale që lidhen me arsimimin, integrimin, dhe rritjen e aksesit në shërbime. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shërbime ditore emergjence për fëmijë dhe familje në nevojë / Nisma ARSIS e cila mundëson shërbime multidisiplinare në ndihmë të fëmijëve e të rinjve në gjendje vështirë financiare.

Objektivi III për këtë program është: Ndhmë ekonomike ose shërbime të përkujdesit me Fondet e Buxhetit Vendor për familjet me shumë pjesëtarë apo familje në nevojë. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mbrojtja sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashtuara nga skema e NE. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 3,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 2,476,814 lekë ose 83% e planit 4-mujor.

Objektivi IV për këtë program është: Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paafte të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Komisione për pagesa PAK/NE. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 6,407,650 lekë nga të cilat është realizuar 2,971,750 lekë ose 46% e planit 4-mujor

Objektivi V për këtë program është: Zbatimi i Masës së Mbrojtjes të marrë nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shërbim Eksperti të Liçensuar. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 200,000 lekë nga të cilat është realizuar 50,000 lekë ose 25% e planit 4-mujor.

Objektivi VI për këtë program është: Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi në Bashkinë e Tiranës, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të këshillimit me telefon 24/7 për të gjithë familjet, gratë, fëmijët dhe adoleshentët që jetojnë në territorin e Bashkisë së Tiranës. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Linja këshilluese dhe shërbime mbështetëse për familje në nevojë / Alo 116 111 dhe Alo 116 117. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 80,515,450 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim. Ky projekt synon të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së grave dhe vajzave, dhe të rinjve me një shërbim 24 orë në çdo ditë të javës.

Objektivi VII për këtë program është realizuar produkti:

Produkti 1: Projekti “Sipërmarrja ime për shkollën”. Pilotimi i këtij projekti është një iniciativë e Bashkisë së Tiranës për të përfshirë dhe bërë pjesë aktive rininë shkollore në proceset vendimmarrëse të planifikimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve për përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës arsimore të shkollave të tyre.

Objektivi VIII për këtë program është: Mbështetja e të rinjve dhe të rejave në sipërmarrjet e tyre duke u dhënë mundësi punësimi. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”. Fondi për gratë sipërmarrëse, i financuar nga burime publike është projektuar për të mbështetur krijimin ose zgjerimin e aktiviteteve të zbatueshme të biznesit nga gratë, të afta për të pasur sukses në një treg konkurrues. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 10,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Objektivi IX për këtë program është: Fuqizimi dhe integrimi nëpërmjet shërbimeve psiko-sociale të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore të cilët aftësohen për t’u integruar në komunitet dhe për të marrë të gjitha shërbimet shëndetësore dhe psiko-sociale. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 15,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Objektivi X për këtë program është: Mbështetja e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike, dhe mësimin e shprehive për t’u kujdesur për të porsalindurin. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shporta e Bebes. Synimi i kësaj shporte është mbështetja në ditët e para të lindjes, me produktet e nevojshme dhe të domosdoshme për çdo nëne, e cila ka sjellë në jetë një bebe. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 23,997,500 lekë nga të cilat është realizuar 2,667,500 lekë ose 11% e planit 4-mujor.

## **19. Programi “Strehimi Social”**

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2023, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 36%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative	36%
- Shpenzime kapitale	0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2023	Plani 4M 2023	Fakti 4M 2023	Realizimi në %
Shpenzime të tjera operative	379,947,142	198,987,834	70,878,008	36%
Shpenzime kapitale	1,686,847,184	-	-	0%
<b>Totali</b>	<b>2,066,794,326</b>	<b>198,987,834</b>	<b>70,878,008</b>	<b>36%</b>

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi i këtij programi është: Subvencionimi i qirasë me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesit sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për strehimin.. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2023, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Subvencionimi i qirasë. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 50,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 50,000,000 lekë ose 100% e planit 4-mujor.

Produkti 2: Projekti Shtrati i Lumit Lana – Rizhvillimi Urban.

Produkti 3: Zbatimi i projektit “unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës”, ka për qëllim strehimin e familjeve, banesa e të cilëve preket nga ky projekt, deri në sistemimin me strehim.

Produkti 4: "Për trajtimin me subvencionin e qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit, me qëllim realizimin e projektit "Për zonën e re për zhvillim, në Njësitë Administrative Nr. 4 dhe Nr. 8, Zona 5 Maji". Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 22,300,000 lekë nga të cilat është realizuar 3,168,000 lekë ose 14% e planit 4-mujor.

Produkti 5: "Për trajtimin me subvencionin e qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit, me qëllim realizimin e projektit "Për zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative Nr. 6, Zona Kombinat". Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 20,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 8,670,000 lekë ose 43% e planit 4-mujor.

Produkti 6: Shërbime postare, me qëllim ofrimin e shërbimit të pagesës së qirasë nga Posta Shqiptare sh.a. në favor të përfituesve të qirasë për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019.

Produkti 7: Shpenzime për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për familjet pa të ardhura që aplikojnë për Programet e Strehimit. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 1,440,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Produkti 8: Projekti “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë”. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 20,000,000 lekë nga të cilat nuk ka patur realizim.

Produkti 9: Subvencionimi i interesave të Kredisë. Ky program synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës nëpërmjet kredive hipotekore me kushte lehtësuese. Plani i planifikuar për 4-mujorin 2023 është 20,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 4,491,947 lekë ose 22% e planit 4-mujor.

# KAPITULLI III

## ECURIA

### E


## BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITET 2019-2023

Trendi i kryerjes së shpenzimeve të buxhetit ndër vite paraqitet si më poshtë, në bazë të klasifikimit ekonomik dhe me të gjitha burimet e financimit në Bashkinë Tiranë:

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Fakti 4M 2020	Fakti 4M 2021	Fakti 4M 2022	Fakti 4M 2023
<i>Shpenzime personeli</i>	1,733,214,593	1,896,724,461	1,945,867,789	2,244,594,772
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	2,583,248,532	3,447,546,087	2,838,308,613	2,984,816,312
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,155,427,395	2,189,556,062	2,091,186,767	988,324,627
<b>Totali</b>	<b>5,471,890,519</b>	<b>7,533,826,610</b>	<b>6,875,363,170</b>	<b>6,217,735,711</b>

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:



## Klasifikimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit vitet 2019 - 2023

në lekë

Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fakti 4M 2020	Fakti 4M 2021	Fakti 4M 2022	Fakti 4M 2023
<i>Të ardhura BT</i>	2,989,101,842	3,402,518,039	3,119,757,963	3,745,456,726
<i>Transferta e Pakushtëzuar</i>	957,814,049	750,995,795	1,128,379,222	984,801,800
<i>Transferta e Pakushtëzuar /Rindërtimi</i>		1,836,319,075	1,391,119,929	297,472,094
<i>Transferta e Kushtëzuar</i>	1,524,904,783	1,543,819,698	1,234,755,142	1,188,668,118
<i>Donacione</i>	69,845	174,003	1,350,913	1,336,973
<b>Totali</b>	<b>5,471,890,519</b>	<b>7,533,826,610</b>	<b>6,875,363,170</b>	<b>6,217,735,711</b>

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:

